

SI TË KRIJOJMË MJEDIS MË TË MIRË PËR TË RINJTË

HYRJE

Zgjerimi i nyjës mes rajoneve urbane dhe rurale në lidhje me të ardhurat, mirëqenien, resurset dhe statusin arsimor kanë potencuar sfidën për zhvillim dhe përmirësim të kushteve në mjediset rurale. Zhvillimi sipas natyrës është një përmbledhje e ndryshimeve. Procesi i zhvillimit rural zakonisht është lidhur me urbanizimin e shpejtë, transformimin e bujqësisë, zhvillimin teknologjik, etj. Pjesa më e madhe e popullatës që jeton në vendet në zhvillim, gjatë njëzet viteve të fundit, do të vazhdojë që jetë rurale. Kjo është e rëndësishme për vendet më pak të zhvilluara, që deri në vitin 2030 përqindja e popullatës në rajonet rurale do të tejkalojë 55% nga popullata e plotë (IFAD, 2011).

Arsimi konsiderohet si një agjent potencial për ndryshime sociale dhe zhvillim dhe prandaj intervenimet në këtë drejtim planifikohen dhe zgjidhen në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar (Karanam dhe Panigrafi, 2010). Personat e pjesës rurale, posaçërisht të rinjtë, nuk janë vëzhgues pasit të trendëve të punësimit. Burim kryesor i punësimit në mjediset rurale është bujqësia, ekonomi personale ose si punëtor në fermë të huaj, më tutje ka mundësi për punësim në ndonjë industri, dhe me vëllim të caktuar paraqitet edhe mundësia për punësim në pjesën e shërbimeve turistike lidhur me resurset e gatshme natyrore dhe kulturore. Trajnimi përkatës mund të ndihmojë edhe popullatën rurale për të përballuar me ndryshimet sociale dhe ekonomike, si të shfrytëzojë mundësinë për zhvillim personal për të përmirësuar jetën e tyre.

Ky dokument jep një pasqyrë të disa prej çështjeve kryesore dhe mundësive për investim në të rinjtë. Të rinjtë, veçanërisht në mjediset rurale, shpesh nuk kanë drejtime dhe mbështetje të nevojshme që tërësisht të kontribuojnë për zhvillimin e komuniteteve të tyre, me çfarë mbështetet rrethi i mungesës së zhvillimit dhe varfërisë rurale. Njohja e trajtimi i nevojave të tyre është me rëndësi të madhe për zhvillimin lokal dhe kombëtar. Në dokumentin theksohet që rëndësia e përforcimit të qasjes së të rinjve nga mjediset rurale në arsim dhe trajnim, si dhe në resurse produktive, por edhe në bashkëpunim dhe rrjetëzim të aktorëve kryesor në komunitet.

ZBULIME KRYESORE

Prej tetë rajoneve statistikore të Republikës së Maqedonisë, pjesa më e madhe e banorëve gjendet në Rajonin e Pollogut (15.5%) Numri i të rinjve është më i përfaqësuar në këtë rajon me moshë mesatare prej 36.5 vite, në krahasim me mesataren kombëtare prej 39 viteve moshë mesatare të popullatës (ESHS, 2018). Përqindja e papunësisë së popullatës në Rajonin e Pollogut është në grupin e shkallëve më të larta (29%), bashkë me Rajonin Verilindor (35.7%) dhe Rajonin Jugperëndimor (30.5%), në krahasim me përqindjen mesatare prej 22.4% në nivel të republikës (ESHS, 2018).

Tre trendët kryesore demografike me implikime për gjasat e punësimit në mjediset rurale janë: numri i të rinjve që hyjnë në tregun e punës, urbanizimi dhe migracioni nga viset rurale (IFAD, 2016). Në Republikën e Maqedonisë, vetëm rreth 6% të punëtorëve të rinj punojnë për vete, ashtu që një përgjigje e dukshme e politikës duhet të jetë tentimi të tërheqin të rinjtë drejt sipërmarrjes si zgjidhje (Elder dhe Bashk., 2013). Sektori i bujqësisë është furnizuesi më i lartë i vendeve të punës për të rinjtë në gjithë territorin. Qasja në financime është një sfidë e madhe – pothuaj se gjysma (46.8%) e të rinjve të vetë-punësuar në vend në anketën e Elder dhe Bashkëpunëtorët (2013) kanë theksuar që mungesa e qasjes në kapital është sida e tyre më e rëndësishme.

Në drejtim të përmirësimit të kushteve për ngritjen e njohurive personale dhe shkathtësive, si dhe përfitimin e shkathtësive dhe njohurive për nevoja përkatëse të tregut të punës dhe të rinjve në përgjithësi, Rrjeti për Mësimin Gjatë Gjithë Jetës së Maqedonisë në bashkëpunim me GLA Skardus në vitin 2018 ka zbatuar një hulumtim empirik për gjendjen aktuale, në të cilën ishin përfshirë 115 persona që janë përgjigjur pyetësorit të përbërë prej 10 pyetje nga e cila ishte pasqyruar gjendja me të rinjtë.

Duke analizuar rezultatet e hulumtimeve dhe kontaktet e drejta dhe bisedat në jetën e përditshme, kemi arritur në rezultate që detyrojnë të mendojmë për ndërmarrjen e aktiviteteve më të gjera dhe më të plota për përmirësimin e situatës së të rinjve, gjegjësisht të krijimit të mjedisit më të mirë për jetesë.

Kjo situatë kryesisht ndodh për shkak të mungesës së informimit dhe masave nga ana e vetëqeverisjes lokale dhe institucioneve shtetërore. Numri i pamjaftueshëm i trajnimeve dhe kapaciteti i mangët i gjithë palëve të interesuar është një prej faktorëve kryesor për këtë situatë. Megjithatë, ajo që jep shpresë për ndryshimin e gjendjes është vetëdija në rritje dhe interesi për trajnime dhe ngritje të njohurive. Interes më të lartë nxisin temat e zhvillimit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, ngritja e kapaciteteve për bashkëpunim mes institucioneve lokale, sektorin afarist dhe OJQ sektorin, si dhe rrjetëzimin mes mbledhjen e mjeteve financiare dhe teknikave për menaxhim me projekte. Duhet të theksohet që ka interes edhe për trajnime të arteve të vjetra dhe prodhimtari organike.

Pjesa më e madhe e bashkëfolësve dhe të anketuarve në hulumtimi i Rrjetit për Mësimin Gjatë Gjithë Jetës dhe GLA Skardus përgjigjen që ka nevojë për:

- mbështetje financiare për formim, edukim dhe aktivitete aktuale së paku për 3-5 vitet e para për shoqatat e reja të formuara,
- mbështetje të shoqatave aktuale dhe shoqërive kulturore artistike si përfaqësues të vlerave tradicionale,
- nevoja për edukim në përputhje me nevojat e tregut të punës,

- ofertë të mundësive për vullnetarizëm si parakusht për përfitimin e njohurive të reja dhe shkathtësive, si dhe ngritje të njohurive dhe shkathtësive aktuale,
- mësimi i artizaneve të vjetra tradicionale,
- Nxitje të hapjes së vendeve të reja të punës për gjeneratat e reja me anë të trajnimit për të rinjtë, si ciceron nëpër Malin Sharr, përmendoreve kulturore dhe historike të Rajonit të Pollogut dhe Malit Sharr.
- hapje të bizneseve të vogla të reja ose bizneseve familjare që tani janë aktuale në rajonin e malit Sharr,
- edukim (përgatitje) e të rinjve për fillim të bizneseve personale të qëndrueshme, gjithashtu për profesione si kontabilist, parukier dhe artizane tjera,
- lidhja e aktiviteteve mes shoqatave,
- rritja e mundësive për bashkëpunim mes aktorëve në komunitet,
- ofrim të trajnimeve për hartim dhe zbatim të projekteve.

DREJTIME DHE REKOMANDIME

Hulumtimet dhe përvoja nuk tregojnë përfshirje të mjaftueshme të të rinjve në jetën shoqërore, njohje të vogël të traditave, mungesa e vendeve të mjaftueshme të punës në përputhje me arsimin e tyre dhe kualifikimeve, rroga zhgënjyese të ultë, mungesa e njohjes me mundësitë për vetë punësim, mungesë e nivelit të sipërmarrjes dhe njohurive përkatëse, shkathtësi dhe aftësi, mungesë e informacioneve dhe njohuri për qasje në financa, numër të pamjaftueshëm të trajnimeve për hartimin e projekteve dhe qasje për financim të projekteve.

Duke u nisur nga ana lizat dhe hulumtimi në teren i zbatuar nga MDU dhe GLA Skardus (2018) këtu me fokus të veçantë për kyçjen e të dhënave dhe krijimi i mjedisit më të mirë për ata, mund të jepen rekomandimet vijuese dhe drejtimit që meritojnë vëmendje dhe intervenime të mëtutjeshëm:

- Duhet një **adresim i sistematizuar dhe rritje të vetëdijes** për probleme me të cilat përballohen të rinjtë që jetojnë në territorin e komunave Jegunovcë, Tetovë dhe Tearcë, si parakushte për përcaktimin e drejtimit në të cilin duhet të lëviz zhvillimi dhe krijimi i mjedisit më të mirë dhe stimulues për të rinjtë.
- Duhet një **bashkëpunim më të lartë mes institucioneve lokale, sektorin afarist dhe sektorin e OJQ** me anë të organizimit të grupeve të punës në të cilat do të shkëmbehen mendime dhe qëndrime për aktivitet që janë të nevojshme për realizmin me qëllim të mundësimin të zhvillimit të qëndrueshëm dhe përdorimin më të gjerë të fondeve të BE-së nga ana e shoqatave të të rinjve, si dhe sipërmarrësit e rinj.
- Duhet një inkurajim më i lartë i të rinjve që të gjenden në rolin e **sipërmarrësve**. Në këtë drejtim sipërmarrja duhet të zhvillohet me anë të trajnimeve përkatëse dhe nxitje të iniciativave për marrjen.
- Vërehet nevoja për edukim, me anë të **trajnimeve dhe seminareve** dhe mungesë të bashkëpunimit që sjell prodhimtari. Vetëm një lloj i edukimit nuk mund të plotësojë nevojat e llojllojshme për mësim të popullatës rurale. Në një mjedis në të cilin gjithnjë e më tepër

paraqiten aktivitete jo-bujqësore, arsimi në funksion të zhvillimit rural kërkon një qasje të plotë që tejkalon kufijtë e ngushtë të arsimit dhe trajnimit tradicional.

- **Ngritja e kapaciteteve** të popullatës rurale, sektorit afarist dhe OJQ sektorin mund të zhvillohet edhe në **tema konkrete**. Në hulumtimet paraprake, si tema më aktuale janë theksuar ato lidhur me bujqësinë dhe zhvillimin rural, zhvillimin e kapaciteteve, bashkëpunimi dhe rrjetëzimi me institucionet lokale, sektorin afarist dhe OJQ sektorin, menaxhimin e projekteve dhe mënyrat e financimit.
- Duhet të theksohet që ka interes edhe për trajnime mbi tema më specifike si për shembull për procesin e mësimin të **artizaneve të vjetra tradicionale** dhe çfarë e përbën këtë proces. Me këtë do të rritet vetëdija dhe njohuria e palëve të interesat për atë se çfarë kontribute sjell një proces i këtillë, do të kontribuonte për ruajtjen e këtyre artizaneve, transferimi në gjeneratat e reja, dhe me atë do të hapen edhe mundësi të reja për angazhim të të rinjve dhe punësim potencial.
- Duhet të ndërmerren aktivitete konkrete për **realizimin e nevojave të përcaktuara** që dalin nga anketat formale dhe joformale dhe hulumtimet.
- Të bëhet një **hulumtim plotësuese** që do të merrte konkretisht gjendjen e të rinjve, në këto tre komuna, me çfarë do të krijohen informacione më relevante, specifike dhe të freskëta për zgjedhjen e problemeve me të rinjtë, gjegjësisht do të kemi bazë për masa dhe aktivitete më konkrete.

KONKLUZION

Duke marrë parasysh që në fokus janë të rinjtë nga mjediset rurale me mundësi të kufizuar në territorin e komunave Jegunovce, Tearce dhe Tetovë me një llojllojshmëri më të shprehur, janë të nevojshme hulumtime më të gjera për nevojat dhe sfidat që do të jenë më përfshirëse për mjediset përkatëse dhe në tërësi.

Arsimi i të rinjve, si atë formale, por veçanërisht në atë joformale dhe mësimin gjatë gjithë jetën, është vegla kryesore për aftësimin e të rinjve. Një theks të veçantë duhet të vendoset në nxitjen e sipërmarrjes dhe inovacionin tek të rinjtë. Më tutje, duhet një bashkëpunim mes sektorëve me të cilën do të sigurohet zhvillim i qëndrueshëm jo vetëm në territorin e komunave, por edhe të shoqërive të të rinjve, sipërmarrësve të rinj dhe të rinjtë në përgjithësi. Ky bashkëpunim mes sektorëve mund të arrihet me rrjetëzim më të lartë të institucioneve lokale, sektorin afarist dhe sektorin joqeveritar me projekte që individualisht do të zgjedhin ndonjë prej problemeve me të cilat përballohen të rinjtë. Ky partneritet mund të kontribuojë për rrjedhje më të shpejtë dhe më cilësor dhe qasje në informacione me të cilët të rinjtë do të jenë më të informuar për projektet dhe programet për zhvillim rural dhe zhvillimin në mjediset urbane dhe çfarë mundësi ofrohen.

Me këtë do të kontribuohet për përdorimin më të mirë të mjeteve në dispozicion nga palë të ndryshme, por më së tepërmi nga Bashkimi Evropian me anë të IPARD II programit. Përdorimi më i lartë i tyre drejtpërdrejtë do të nxit zhvillimin e rajonit, me anë të hapjes së vendeve të reja të punës, tërheqjen e turistëve, rregullimin e vendbanimeve rurale dhe përmirësimin e plotë të jetës.

BURIMET

Elder, S., Novkovska, B., Krsteva, V. (2013) Kalimi i Grave dhe Burrave të Moshës së Re në Tregun e Punës në Ish Republikën Jugosllave të Maqedonisë. Zyra Ndërkombëtare e Punës, Gjenevë.

Raporti për Varfërinë Rurale të vitit 2011 përgatitur nga IFAD

MDU dhe GLA Skardus (2018) Mësimi Gjatë Gjithë Jetës për Zhvillim Rural – Hulumtimi i OJQ-ve, popullatës rurale dhe sektorit afarist që punojnë në Rajonin e Pollogut në fushën e zhvillimit rural, pjesëmarrja e tyre në procesin e vendimmarrjes, bashkëpunimi i ndërsjellë dhe bashkëpunim me institucionet lokale. Tetovë, 27 faqe.

IFAD (2010). Rural Poverty Report 2011: New Realities, New Challenges: New Opportunities for Tomorrow's Generation. Rome.

Karanam, P. & Panigrabi, S.C. (2010). Draft from ERT' 2010: Education for Rural Transformation: Realities and Challenges in India. 8-10 November 2010, Stockholm University, Stockholm.

INFORMACIONE PLOTËSUESE

GLA Skardus, Vojislav Antovski, 071 275 164, lag.skardus@gmail.com, www.lagskardus.mk

OJQ EKOPRODUKT TETOVË, Nesim Veliu, 070 632 818, ekoprodukt2006@gmail.com, nesim_v@yahoo.com,

QENDRA KULTURORE RINORE Tetovë, Burim Veliu, 070 471 10, burim07@gmail.com